



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË  
MUNICIPAL OF ASSEMBLY-SUHAREKË  
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d), nenin 51, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenin 29 dhe 39 të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, nenin 4 lidhur me nenin 7 dhe 9, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.03/2014, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 15.01.2018, miratoj këtë:

### V E N D I M

Për themelimin e komiteteve të përhershëm.

#### Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës në Suharekë, themelon komitetet e përhershëm dhe përcakton numrin e anëtarëve si më poshtë;

1. Komitetin për politik dhe financa dhe do të ketë---7, (shtatë) ulëse-anëtarë
2. Komitetin për Komunitete dhe do të ketë-----7, (shtatë) ulëse-anëtarë

#### Neni 2

2.1 Përbërja e Komitetit për politik dhe financa, duhet të reflektoj përfaqësimin e entiteteve politike si dhe numrin e ulëseve nga entitetet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës.

2.2 Përbërja e Komitetit për Komunitet duhet të jetë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë jashtë tije.

#### Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve të përhershme, janë të përcaktuara me Ligjin Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), dhe Statutin e Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008 dhe aktet tjera Ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

#### Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

### KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr-112-2169  
Me datë 16.01.2018

Anëtari më i vjetër i Kuvendit

  
Salih BYTYÇI